



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



QENDRA KOMBËTARE BURIMORE
PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Konferencë Kombëtare e Shoqërisë Civile 2020

D h j e t o r 2 0 2 0

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri zbatohet në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe Lëvizjen Evropiane në Shqipëri



Mirënjohje


Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile dhe Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim shpreh mirënjohjen për prezencën dhe kontributin e të gjithë pjesëmarrësve në konferencë: përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të komunitetit donator në vend dhe institucioneve ndërkombëtare si dhe aktivistëve të shoqërisë civile.

Një falenderim i veçantë shkon për folësit në panel, SH.T.Z. Luigi Soreca për prezencën dhe fjalën e tij, për të gjithë organizatat dhe rrjetet e OSHC-ve që propozuan dhe udhëhoqën workshopet tematike në “HAPËSIRË DISKUTIMI” si dhe për grupin e punës të konferencës për kontributin në evidentimin dhe sjelljen për diskutim në këtë konferencë të problemeve kryesore, sfidave dhe perspektivave zhvillimore të sektorit për të ardhmen.

© 2020 National Resource Centre for Civil Society in Albania, Partners Albania for Change and Development. All rights reserved.
Tirana, Albania

Informacioni dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë dokument janë ato të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian. As institucionet dhe organet e Bashkimit Evropian, as cilindo person që vepron në emër të tyre, nuk mund të konsiderohet përgjegjës për përdorimin që mund të bëhet nga informacioni që përmban ai.

Të dhëna nga Konferenca



Përmbledhje

Konferenca Kombëtare e Shoqërisë Civile në Shqipëri, mbajtur më 4 dhjetor, 2020, solli bashkë në një takim virtual, rreth 135 përfaqësues të organizatave, rrjeteve dhe aktivistë të shoqërisë civile si dhe përfaqësues të komunitetit donator dhe organizatave ndërkombëtare në vend, për të diskutuar rreth zhvillimeve në sektor në këto dy vite të fundit, por edhe përtej tij, duke iu referuar zhvillimeve politike, sociale dhe ekonomike në vend, dialogut politik dhe momentit në të cilin ndodhemi lidhur me progresin e bërë dhe sfidat në rrugën drejt integritimit të vendit në Bashkimin Evropian.

Konferenca u organizua në dy sesione kryesore, në sesionin e parë “Demokracia dhe Shoqëria Civile” – Një vlerësim kritik mbi situatën, zhvillimet dhe sfidat” pati tre fjalë nga panelistë, përfaqësues të sektorit, të cilat u pasuan nga diskutime nga pjesëmarrësit sipas tri shtyllave kryesore, për të eksploruar më tej problemet kryesore, sfidat dhe perspektivat e OSHC-ve. Në sesionin e dytë të Konferencës “HAPËSIRË DISKUTIMI”, pjesëmarrësit diskutuan në 8 Workshope tematike, mbi çështje të propozuara nga vetë organizatat në konferencë. Workshopet u udhëhoqën nga vetë organizatat propozuese me synimin për të gjeneruar diskutim në sektor dhe eksploruar së bashku mënyra bashkëpunimi për avancimin e çështjeve dhe dialogun me institucionet dhe aktorë të tjerë.

Dizenjuar si një takim i madh diskutimi i sektorit, konferenca synoi identifikimin e problematikave kryesore, mënyrave dhe mjeteve për forcimin e dialogut ndër-sektorial e ndër-institucional, si dhe për rritjen e bashkëpunimit mes OSHC-ve dhe aktorëve të tjerë për çështjet që u adresuan në panele diskutimi dhe workshope.

Ky dokument është një përmbledhje e fjalëve dhe diskutimeve në panele, si dhe diskutimeve dhe rekomandimeve në grupet dhe workshopet tematike të konferencës. Ai është ndarë gjerësisht me të gjithë aktorët e përfshirë në konferencë dhe aktorë të tjerë në qendër të diskutimeve, si dhe me grupet e interesit dhe publikun e gjerë.

Në vijim dokumenti do të diskutohet me aktorë të tjerë dhe institucione për ndjekjen e çështjeve të ngritura nga OSHC-të dhe rekomandimet e tyre.

Fjala Përshëndetëse

Znj. Ariola Agolli,
Menaxhere, Qendra Kombëtare Burimore
për Shoqërinë Civile në Shqipëri

Në fjalën e hapjes së konferencës, Znj. Ariola Agolli theksoi rolin kyç dhe kontributin që sektori luan në forcimin e demokracisë, shtetit të së drejtës, zhvillimit ekonomik, përfshirjes sociale dhe ofrimit të shërbimeve, duke cilësuar rolin që OSHC-të luajtën në përballimin e dy situatave shumë të vështira si pandemia e Covid 19 dhe situata e post tërmetit të fundvitit të kaluar me të cilën u përballën mijra qytetarë.

Më tej, ajo prezantoi disa arritje të Qendrës në dy vitet e funksionimit të saj si dhe theksoi rëndësinë e këtij investimi strategjik në mbështetje të sektorit jofitimprurës në vend për fuqizimin e tij të mëtejshëm dhe rritjen e rolit në politikëbërje dhe në procesin e integritit të vendit në Bashkimin Evropian.

Krahas listimit të disa problematikave kryesore me të cilat përballesh OSHC-të dhe mungesës së progresit vitet e fundit sa i përket mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile, Znj. Agolli u ndal edhe në sfidat e brendshme të sektorit si qendrueshmëria, rritja e standardeve, transparencës dhe llogaridhënies etj. "Nisma e Kodit të Standardeve dhe zbatimit të tij është një mekanizëm për të cilët po punohet në këtë drejtim dhe shprehje e qartë e angazhimit të sektorit për të forcuar gjithnjë e më shumë komunikimin dhe transparencën publike, si një mjet i rëndësishëm në forcimin e besimit publik".

Sh.T. Z. Luigi Soreca,
Kreu i Delegacionit të Bashkimit
Evropian në Shqipëri

Në fjalën e tij, Ambasadori i BE-së Luigi Soreca vlerësoi organizimin e kësaj konference kombëtare nga Qendra Burimore dhe Partnerët Shqipëri si dhe pjesëmarrjen e madhe të organizatave dhe aktorëve të tjerë për të diskutuar sfidat me të cilat përballesh. Ai theksoi që OSHC-të luajnë një rol vendimtar në zhvillimin demokratik të Shqipërisë dhe në pranimin e saj në BE. "Ne do të vazhdojmë të mbështesim zhvillimin e organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri. Përfshirja e shoqërisë civile në hartimin e politikave është thelbësore por aktualisht e pakënaqshme në Shqipëri. Autoritetet publike duhet të sigurojnë pjesëmarrjen e shoqërisë civile në proceset e reformave.

Në Raportin e tij të fundit të Progresit, Komisioni Evropian u detyrua të nënvizonte se "nuk është bërë përparim thelbësor për zbatimin e udhërrëfyesit për një mjedis mundësues për shoqërinë civile". Kjo gjendje nuk është e pranueshme dhe duhet të përmirësohet. Duhet ende përpjekje të rëndësishme për të patur procese efektive konsultimi me shoqërinë civile përpara se të miratohet legjislati.

"Konsultimet që nuk bëhen në mënyrë konsistente dhe koherente, mund të kompromentojnë cilësinë e ligjeve të reja dhe hapat e ardhshëm në procesin e pranimit. I nxitim me forcë institucionet, që nga ekzekutivi deri te dega e legjislativit, nga niveli vendor tek ai qendror, të tregojnë vullnet politik dhe të rrisin në mënyrë të konsiderueshme përkushtimin e tyre konkret për t'u angazhuar sistematikisht me shoqërinë civile – ashtu siç bën çdo demokraci moderne" tha Ambasadori i BE-së, Luigi Soreca.



Demokracia dhe Shoqëria Civile
Një vlerësim kritik mbi situatën,
zhvillimet dhe sfidat

Tema 1: Tkurrrja e hapësirës për shoqërinë civile, mjedisi mundësues dhe roli i sektorit në rugën drejt anëtarësimit në BE

Fjala Hyrëse: Z. Gjergji Vurmo, Drejtor Programi, Instituti për Demokraci dhe dërmjetësim (IDM)

"Jemi munduar të përgatisim veten në kuadër të procesit të integritit evropian por të vetmet zhvillime që kanë ndodhur në këto 7 vjet janë marrja e statusit të vendit kandidat më 2014 dhe vendimi i marsit 2020 për hapjen e negociatave, i cili nuk është materializuar ende. Nga ana tjetër, qeveria ka aprovuar modalitetet e përfshirjes së shoqërisë civile në kuadër të negociatave. E ka bërë në konsultim me OSHC-të por pa reflektuar feedbackun tonë" theksoi Z.Vurmo në fjalën e tij. Lidhur me mjedisin mundësues për sektorin, Z. Vurmo theksoi që ka disa arritje shumë të rëndësishme në periudhën 2013-2016 dhe më tej gjatë 4-5 viteve të fundit kemi një rënie drastike të optimizmit. Ligji për të drejtën e informimit dhe ai për konsultimin publik kanë ende problematika. KKSHC nuk ka përmbushur pritshmëritë dhe sidomos Roadmap për mjedisin mundësues ka patur progres të dobët. Ka një shtim të sulmeve nga ana e qeverisë me nisma ligjore të dyshimta të cilat prekin jo vetëm performancën por edhe pavarësinë tonë dhe rolin tonë në proceset zhvillimore dhe demokratizuese të vendit. Më tej ai u ndal në rolin e donatorëve në vend duke e vlerësuar si thelbësor në mbështetjen e sektorit. "Megjithatë kemi nevojë të përmirësojmë më tej punën tonë dhe marrëdhënien tonë. Ka ardhur koha për një dialog më konstruktiv, më të formalizuar, më të qendrueshëm mes OSHC-ve dhe komunitetit të donatorëve. Në kuadër të këtij dialogu të bisedojmë së bashku për çështje thelbësore që prekin cilësinë e punës tonë, prekin kredibilitetin tonë dhe tuajin."

Konkluzione nga diskutimi me OSHC-të

Problematika

- Hapësira ku organizatat veprojnë por dhe mundësitë për t'u përfshirë në procese ka qenë gjithnjë e më e ngushtë veçanërisht në situatën pandemike të vitit të fundit. Shumë nga proceset konsultuese të institucioneve konsiderohen fiktive, pa reflektimin e opinionit në draft ligjet apo politikat që konsultohen, veçanërisht në nivel vendor.
- Trajtimi fiskal i sektorit (përfshi dhe rimbursimin e TVSH-së për grante) vazhdon të mbetet problematik dhe ndikon në tkurrjen e hapësirës për veprimtarinë e OSHC-ve.
- Pas eksperiencës negative të zbatimit të Udhërrëfyesit të parë, ka një pikëpyetje të madhe për zbatueshmërinë e të dytit dhe skepticizëm për procesin, për aq kohë sa ska asnjë informacion për zbatueshmërinë dhe mekanizmat e monitorimit nga ana e OSHC-ve.
- Hartimi i ligjeve që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në veprimtarinë e OSHC-ve (p.sh. Projekt Ligji për Regjistrimin e OSHC-ve, Për regjistrin e llogarive bankare etj) si dhe koha e te zgjatur e plotësimit të ligjeve me akte ligjore (p.sh. Ligji për Vullnetarizmin, Rininë, Ndërmarrjet Sociale etj) shkakon paqartësi, ndikon negativisht dhe pengon veprimtarinë e OJF-ve.
- Qendrueshmëria e OSHC-ve. Veçanërisht OSHC-të lokale dhe në zona periferike, kanë kapacitete të ulta dhe vështirësi në aksesimin dhe menaxhimin e fondeve.
- KKSHC nuk është strukturë funksionale, por thjesht fiktive. Mungon komunikimi me OSHC-të në të gjithë vendin. KKSHC nuk luan rolin këshillues që duhet të ketë për krijimin e mjedisit mundësues në marrëdhënien me institucionet.
- KKIE si mekanizëm dhe strukturë këshilluese, ka probleme në funksionim dhe cilësinë e konsultimit.

Rekomandime

- Zbatimi i Udhërrëfyesit për Zhvillimin e Shoqërisë Civile dhe përfshirja e OSHC-ve në monitorimin e zbatimit të tij.
- Përfshirje reale e OSHC-ve në konsultime, grupe pune e tryeza diskutimi në kuadër të negociatave dhe integritit të vendit në BE.
- Të zbatohet ligji për konsultimin dhe të ridimensionohet gjithë koncepti dhe procesi i proceseve konsultuese, rolit të shoqërisë civile në vendimmarrjen në nivel qendror dhe vendor.
- Rivlerësim i strukturave të Këshillit Kombëtar të Integritit Evropian (KKIE) dhe Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC).
- Të forcohet përfaqësimi dhe roli i shoqërisë civile në KKIE, jo vetëm për forcimin e rolit të këtij këshilli por dhe në kuadër të vetë procesit të integritit evropian.
- KKSHC të realizojë funksionin për të cilin u krijua, të parashtojë problemet e shoqërisë civile në diskutime me përfaqësuesit e qeverisë që të përkthehen në politika që sigurojnë mjedis mundësues për sektorin.
- Donatorët të dizenojnë programe financimi afatgjata për OSHC-të, në përputhje me prioritetet e vendit dhe hartuar përmes proceseve të gjera konsultuese me përfaqësues të OSHC-ve dhe aktorëve të tjerë.
- Programe për rritjen e kapaciteteve të OSHC-ve, veçanërisht me fokus diversifikimin e burimeve të financimit, qendrueshmërinë financiare zhvillimin organizativ.

Fjala Hyrëse: Znj. Erida Skëndaj, Drejtore, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Znj. Erida Skëndaj në fjalën e saj theksoi se pavarësisht rolit dhe kontributit të qënësishëm që OSHC-të kanë dhënë në drejtim të monitorimit apo ofrim shërbimesh për të çuar përpara zbatimin e prioritetëve të lidhura me integrimin e vendit në familjen evropiane, vlerësimi nga shteti për kontributin e sektorit nuk është në nivele të duhura dhe shpesh herë anatemohet, në disa raste duke përdorur si kundërgargument mbështetjen që shteti ka nga faktori ndërkombëtar në vend. *“Konsultimi publik me organizatat e shoqërisë civile paraqet një sërë problematikash dhe ka element të theksuar formal, edhe pse Kuvendi ka miratuar një ligj të veçantë që ngarkon institucionet shtetërore përgjegjëse me një sërë kompetencash që mbeten shpesh të pazbatuara në praktikë. Ka patur raste kur, gjuha e përdorur në seancat plenare të Kuvendit ndaj përfaqësuesve të OSHC-ve ka patur elementë fyes dhe frenues, për shkak se sektori ka kundërshtuar paketa shumë debatueshme ligjore të cilat nuk respektojnë Konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti Shqiptar (të KiE, OKB, etj. Shumë organizata të shoqërisë civile mbështetën reformën në drejtësi që në hapat e para të ideimit dhe miratimit të saj, por kur organizatat u përfshinë në monitorimin e zbatimit të saj, mbështetja ndaj tyre, ishte e paktë, shpesh dhe me argumenta që kjo reformë ka mbështetjen e faktorit ndërkombëtar”.*

Konkluzione nga diskutimi me OSHC-të

Problematika

- Rezoluta e Kuvendit për mbrojtësit e të drejtave të njeriut ka karakter deklarativ dhe angazhimet e pasqyruara në të mbeten kryesisht formale.
- Edhe pse disa organizata janë autorizuar nga Ministria e Drejtësisë për të ofruar ndihmë ligjore falas të garantuar nga shteti, ato ende nuk janë financuar për ofrimin e shërbimeve ligjore
- Mosfunksionimi i KKSHC, mungesa e komunikimit me sektorin dhe përfaqësimi me institucionet.
- Zbatimi i Ligjit për Ndërmarrjet Sociale ka rezultuar i pamundur në praktikë.
- Reforma ligjore për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar nuk zbatohet efektivisht ndërkohë që ka nevojë për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me Konventën e UN për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.
- Ligji për shërbimet Shoqërore 121/2016 i dha mundësi organizatave të financohen nga shteti, por krijimi i fondit që do të mundësonte këtë financim, nuk është vendosur në dispozicion.
- Taksat në nivel vendor rëndojnë financat e organizatave që ofrojnë shërbime për PAK (p.sh. tatimi mbi pronësinë).
- Moszbatimi i duhur i ligjit për të drejtën e informimit dhe ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik sjell pengesa në drejtim të përmbushjes së misionit dhe ushtrimit të veprimtarisë së sektorit të OSHC-ve.
- Organizatat në nivel vendor kanë informacion të pakët dhe akses tepër të kufizuar në konsultimin e politikave dhe legjislacionit me rëndësi, ndërkohë që përzgjedhja e OSHC-ve ka element selektive dhe korporatist

Rekomandime

- Propozim dhe miratim i një ligji të posaçëm që garanton mbrojtje efektive për mbrojtësit e të drejtave të njeriut.
- Organizatat e autorizuar nga Ministria e Drejtësisë për të ofruar shërbimin e ndihmës juridike parësore, të financohen pa vonesë.
- Të fuqizohet zëri përfaqësues i shoqërisë civile në mekanizma si KKSHC apo KKIE si dhe vetë sektori të krijojë mekanizma vetërregullues më efikas për të adresuar dhe referuar shqetësimet e tij.
- Rishikim i Ligjit për Ndërmarrjet Sociale, me konsultim të gjerë me sektorin, për krijimin e një mjedisi mundësues e zhvillues për to.
- Të harmonizohet plotësisht legjislacioni i brendshëm, në përputhje me Konventën e UN për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.
- Roli i koordinatorëve të caktuar pranë autoriteteve publike për zbatimin e këtyre dy ligjeve duhet të forcohet si dhe nevojitet rishikimi i mjeteve ligjore të ankimit kur këto dy ligje nuk zbatohen pasi ato nuk janë efektive.

Fjala Hyrëse: Znj. Kristina Voko, Drejtore, Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative Shqipëri (BIRN)

Në fjalën e saj, Znj. Voko u fokusua në problematikat e ndeshura nga përfaqësuesit e shoqërisë civile lidhur me tre të drejta dhe liri themelore në vend. Së pari, lidhur me të drejtën për informim, gjatë dy viteve të fundit të gjitha OJF që merren në mënyrë të drejtpërdrejtë me transparencën proaktive të institucioneve publike por dhe kërkesat për të drejtë informimi kanë vënë re një përkeqësim të situatës, e cila u rëndua dhe më tej nga gjendja e emergjencës. Së dyti, e drejta e tubimit, ku kemi patur një numër të madh të OJF-ve, grupeve të aktivistëve dhe institucioneve publike që kanë reaguar duke bërë thirrje të vazhdueshme për transparencë dhe rregulla më të qarta në lidhje me tubimin. Më tej, në lidhje me lirinë e shprehjes dhe medias, Znj. Voko theksoi që ka patur përkeqësim të situatës, çka vërehet edhe në gjithë progres raportet dhe raporte të tjera ndërkombëtare, të ndikuara kryesisht nga numri i sulmeve fizike dhe denigruese ndaj gazetarëve, ndjekjen penale të gazetarëve dhe administratorëve të medias, si dhe ndryshimet ligjore të propozuara si pjesë e 'paketës anti-shpifje'.

Konkluzione nga diskutimi me OSHC-të

Problematika

- Mungesë transparence nga ana e institucioneve publike në nivel qendror dhe vendor dhe problematika në aksesin në informacion, të cilat janë theksuar edhe më shumë gjatë periudhës së pandemisë.
- Centralizim i informacionit të ofruar gjatë periudhës së emergjencave civile.
- Përkeqësim i procesit të konsultimit publik për akte të rëndësishme, të cilat kanë prekur dhe më shumë grupet vulnerabël dhe komunitetet rurale.
- Mungesa e informacionit nga ana e gazetarëve mbi të drejtat e grupeve vulnerabël, duke sjellë mungesën e vëmendjes ndaj problemeve sociale në vend, nevojave të grupeve vulnerabël dhe rritje të gjuhës së urrejtjes në mediat online dhe ato sociale.
- Mungesa e përfshirjes së grupeve të interesit në hartimin dhe konsultimin e paketës 'Anti-shpifje'.
- Përdorimi i shtuar i videoeve të parapërgatitura nga subjektet politike dhe institucionet publike, të cilat çenojnë të drejtën e informimit të paanshëm dhe lirisë së medias.

Rekomandime

- Rritja e transparencës nga institucionet publike që të mundësohet mbikëqyrja e tyre nga shoqëria civile, si dhe ri-forcimi i rolit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit në marrjen e masave administrative në këtë drejtim.
- Forcimi i mekanizmave të konsultimit publik dhe zbatimi me rigorozitet i ligjit.
- Ndalimi i propagandës dhe sulmeve politike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë civile.
- Rishikimi i ligjit për tubimet, duke përfshirë në të dhe rekomandimet e identifikuara nga Avokati i Popullit dhe organizatat e shoqërisë civile.
- Forcimi i aftësive advokuese të shoqërisë civile dhe të komuniteteve në ngritjen e çështjeve të rëndësishme për ta dhe rritja e bashkëpunimit mes organizatave dhe medias.
- Rritja e kapaciteteve të medias dhe gazetarëve lidhur me raportimin e drejtë mbi çështje të rëndësishme sociale dhe grupet vulnerabël.
- Përfshirja aktive e grupeve të interesit në procedurat e hartimit dhe konsultimit në nismat ligjore që kufizojnë lirinë e shprehjes dhe të medias.

“HAPËSIRË DISKUTIMI”

Workshope tematike

Workshop 1 - Përfshirja e OSHC-ve dhe qytetarëve në avancimin e agjendës lokale

✓ Organizata propozuese: Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

Problematika

- Megjithë ekzistencën e dokumentave strategjike dhe planeve sociale të miratuara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, ato nuk gjejnë zbatim në praktikë.
- Përfshirje e ulët e OSHC-ve në konsultime.
- Moszbatim i mekanizmave në nivel vendor që garantojnë përfshirje qytetare dhe pjesëmarrje reale dhe konsistente në qeverisjen vendore.
- Ndërveprim i ulët mes OSHC-ve dhe grupeve të tjera të shoqërisë civile për të kërkuar llogaridhënie në nivel vendor.
- Kapacitete të ulta të organizatave në nivel lokal për monitorim të institucioneve, advokim dhe rrjetëzim.

Rekomandime

- Fuqizim i kapaciteteve advokuese dhe monitoruese të OSHC-ve në nivel vendor.
- Forcim i rrjeteve dhe koalicioneve mes OSHC-ve në nivel vendor dhe kombëtar për aksione të përbashkëta.
- Rritje e dialogut mes OSHC-ve dhe institucioneve në nivel vendor për zbatimin e mekanizmave ose ngritjen e mekanizmave atje ku mungojnë.
- Promovim i praktikave të mira të pjesëmarrjes, konsultimit dhe monitorimit.

Workshop 2 - Përfshirja e të rinjve dhe organizatave rinore në politikëbërje – Sfidat në pjesëmarrje dhe bashkëpunimin me institucionet

✓ Organizatat propozuese: Europartners Development; Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim; Qendra Rinore Vlorë, Vizion i Ri, Youth Development Through Integration Policies

Problematika

- Përfshirja e ulët e organizatave rinore në proceset vendimmarrëse në nivel vendor dhe qendror.
- Mungesa e kapaciteteve të organizatave rinore për të kontribuar dhe ushtruar presion në organet vendimmarrëse në realizimin e proceseve gjithëpërfshirëse.
- Mungesa e qëndrueshmërisë financiare së organizatave rinore.
- Mungesa e kapaciteteve të organizatave rinore për të absorbuar fondet e Bashkimit Evropian dhe zbatimin e tyre në mënyrë efektive.
- Mungesa e aftësive të organizatave rinore për të ngritur dhe zhvilluar fushata advokimi në nivel vendor e qendror.

Rekomandime

- Rritja e përfshirjes së OSHC-ve dhe të rinjve në konsultime dhe vendimmarrje në nivel vendor dhe qendror.
- Rritja e kapaciteteve të organizatave rinore për të qenë pjesë dhe kontribuar në proceset vendimmarrëse.
- Mbështetje e fushatave/iniciativave advokuese të OSHC-ve dhe grupeve rinore.
- Zhvillimi i programeve të ngritjes së kapaciteteve të organizatave rinore për aksesimin e fondeve të Bashkimit Evropian; menaxhim organizativ dhe projektsh.
- Rritja e partneritetit dhe rrjetëzimit midis organizatave rinore për ngritjen e fushatave të përbashkëta të advokacisë.

Workshop 3-Dinamika e sektorit të shoqërisë civile ndër vite - Dilemat për të ardhmen



Organizatata propozuese: Në Dobi të Gruas Shqiptare; Agjensia Rajonale e Zhvillimit, Vlorë; Qendra Kulturore Mediatike Antigonea.

Problematika

- Zbehja e vullnetarizmit dhe aktivizmit në sektor krahasimisht me vite më pare, ka ndikuar negativisht në imazhin e OSHC-ve, njohjen e punës dhe kontributit të tyre, si dhe në rënien e besimit dhe mbështetjen e qytetarëve ndaj OSHC-ve.
- Vihet re një mjedis jo miqësor ndaj OSHC-ve nga ana e vendimmarrësve dhe për rezultat ekspertiza e fituar ndër vite nuk shfrytëzohet sa dhe si duhet në proceset vendimmarrëse dhe politikëbërëse.
- Trajtimi fiskal i sektorit
- Fonde të pamjaftueshme publike për mbështetjen e veprimtarisë së OSHC-ve. Mungesë mbështetjeje financiare dhe jofinanciare nga shteti, veçanërisht për OSHC-të e vogla dhe ato lokale të cilat nuk i kanë kapacitetet për të aplikuar dhe konkuruar për grante në donatorët e huaj.
- Fokusim i donatorëve të huaj dhe programeve të tyre kryesisht në çështje strategjike të zhvillimit të vendit, si demokracia, qeverisja e mirë, duke lënë jashtë vëmendjes ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjen e tyre.

Rekomandime

- Rritja e standardeve të punës së sektorit, transparencës dhe llogaridhënies me qëllim përmirësimin e imazhit publik dhe rritjen e besimit. Promovim i iniciativave të mira sado të vogla por me impakt në komunitet.
- Fuqizim kapacitetesh i organizatave të vogla dhe zhvillim i ekspertizës së tyre.
- Për të adresuar çështje të mjedisit mundësues përfshi dhe kuadrin fiskal kërkohet një gjithëpërfshirje e OSHC-ve nga gjithë vendi dhe sektorët. Ndërmarrja e iniciativave dhe përpjekje të përbashkëta nga OSHC-të në këtë drejtim.
- Krijimi i mekanizmave për pjesëmarrje efektive të OSHC-ve në vendimmarrje.
- Më shumë mbështetje nga donatorët për sektorin e shërbimeve dhe OSHC-të që i ofrojnë dhe që kanë ekspertizën e nevojshme lidhur me to.
- Rritje e fondeve publike. Mbështetje financiare dhe jofinanciare nga shteti veçanërisht për organizatat lokale dhe për ato që ofrojnë shërbime për grupet në nevojë.

Workshop 4-Shërbimet e integruara për fëmijët në situatë vulnerabël – Sfidat e OSHC-ve dhe nevoja për rritje të bashkëpunimit ndërinstytucional



Organizata propozuese: Nisma për Ndryshim Shoqëror, ARSIS

Problematika

- Mungesë e mbështetjes financiare nga fondet publike në ofrimin e shërbimeve për kategoritë në nevojë dhe plotësimin me burime njerëzore sipas parashikimeve të ligjit nr.121/2016. Mbështetja është e kufizuar vetëm nga OSHC-të.
- Ofrimi i shërbimeve sipas prioriteve dhe mundësive të organizatave dhe institucioneve publike dhe jo në përgjigje të nevojave të identifikuar.
- Bashkëpunime të cingura dhe jo sipas meritokracisë ndërmjet OJF-ve dhe Institucioneve Publike; OSHC-të shihen si mjet dhe jo si partnerë në ofrimin e sugjerimeve dhe alternativave për ndërhyrje, dhe ofrimin e shërbimeve për kategoritë në nevojë.
- Përqëndrim i fondeve drejt shërbimeve që lidhen me Covid-19 ka patur dhe do vijojë të ketë efekt negativ në financimin dhe ofrimin e shërbimeve shoqërore.

Rekomandime

- Politika lehtësuese financiare për OSHC-të dhe përmirësimi i strukturave, burimeve njerëzore për shërbim ofruesit.
- Partneritet funksional dhe i qëndrueshëm ndërmjet institucioneve shtetërore dhe OSHC-ve.
- Adresimi i nevojave të identifikuar dhe përdorim më efektiv i burimeve ekzistuese; Transparencë informacionesh dhe vendosje e një standarti në këtë drejtim.
- Ndërhyrje ndërsektoriale dhe pranimi i perspektivave të ndryshme në ofrimin e shërbimeve për efektivitet më të lartë.
- Kategorizim i shërbimeve të integruara sipas target grupeve dhe ndërthurje e shërbimeve.
- Prioritizim i nevojave të fëmijëve dhe familjeve që vijnë nga situata vulnerabël, e i nevojave të shtuara në kohë pandemie.

Workshop 5-Fuqizimi i rolit të OSHC-ve në hartimin dhe zbatimin e politikave për mbrojtjen mjedisore

Organizatave propozuese: Instituti i Politikave Mjedisore; Rrjeti i Vigjilencës Mjedisore "Një sy për mjedisin"; Organizata "Celim"; Shoqata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror, Vlorë

Problematika

- Kuadër ligjor mbi mbrojtjen e mjedisit i paplotë dhe i transpozuar me direktivat e BE-së.
- Mjedisit dhe mbrojtja e tij nuk është prioritet për vendimmarrësit dhe as komunitetin vetë.
- Shqipëria është e cënuar drejtpërsdrejti nga ndryshimet klimatike. Kjo për shkak të ekonomisë së brishtë, dhe të mangësive në masat për t'u përballur me pasojat e ndryshimeve klimatike.
- Zhvillimi ekonomik shpesh ka cënuar zonat me vlera natyrore me investime që kanë ndikime negative, sidomos në vijën bregdetare dhe zonat e mbrojtura.
- Përfshirja shumë e ulët e OSHC-ve në konsultime dhe vendimmarrjen mjedisore qendrore dhe vendore.
- Politizimi i institucioneve vendore dhe qendrore, krijon vështirësi për OSHC-të në marrjen e informacionit mbi ndërhyrjet mjedisore dhe ndikimet e tyre.
- Mbivendosje rolesh dhe konfuzion në përgjegjësitë institucionale në nivel qendror për menaxhimin e burimeve natyrore dhe të mjedisit.
- Reduktimi i fondeve për mbrojtjen e mjedisit; fondet ekzistuese janë të orientuara drejt organizatave të mëdha, shpesh jo-mjedisore dhe jo të balancuara për veprimin mjedisor dhe fuqizimin e kapaciteteve.

Rekomandime

- Përmirësim dhe rritje e proceseve të pjesëmarrjes dhe konsultimit me OSHC-të mjedisore.
- Amendimi i ligjit për të drejtën e informimit në lidhje me çështjet mjedisore lidhur me detyrimin për ndarjen e informacionit për investimet me ndikim të lartë në mjedis. Lehtësim në hapësirat ligjore për OSHC-të mjedisore për apelim dhe dërgim në gjykatë të rasteve në shkallë.
- Të rishihet vendimmarrja brenda institucioneve zbatuese dhe monitoruese të gjendjes së mjedisit ku si pjesë e Bordit të jenë dhe përfaqësues ekspertë nga OSHC-të.
- Rritje e bashkëpunimit OSHC-institucione vendore për rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit për ruajtjen e mjedisit.
- Rritje e monitorimit të ndotjes dhe shfrytëzimit të mjedisit (veçanërisht e shkarkimeve industriale) si dhe e kapaciteteve monitoruese të shtetit dhe OSHC-ve.
- Aktivizim dhe mbështetje e OSHC-ve në nismat për ndryshimet klimatike për të nxitur dhe bashkuar të gjithë aktorët e shoqërisë në procese të dekarbonizimit të transportit dhe energjisë, dhe përdorimit të energjive të rinovueshme.
- Rritje e koordinimit dhe rrjetëzimit mes OSHC-ve lidhur me çështjen e ndryshimeve klimatike, ekonominë qarkulluese, uljen e varfërisë energjike.

Workshop 6-Vështirësitë e organizatave dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre

Organizatave propozuese: Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësitë Kufizuara (ADRF); Shoqata "Ndihmoni Jetën"; Rreze Shprese

Problematika

- Burime financiare të kufizuara për qëndrueshmërinë dhe zgjerimin e veprimtarisë së organizatave apo ofruesve të shërbimeve në fushën e aftësisë së kufizuar. Aftësia e kufizuar, në programet e financimit të donatorëve të huaj, nuk është një çështje prioritare por trajtohet si cross-cutting, duke thelluar përjashtimin social të personave PAK dhe familjarëve të tyre*. Mbështetja përmes skemave të nëngratimeve afatshkurtër, gjithashtu sjell vështirësi në zbatimin e planeve strategjike të organizatave duke cënuar qëndrueshmërinë dhe standardet e krijuara deri më tani nga OSHC-të.
- Shërbimet ndaj PAK, nuk përbëjnë një çështje prioritare për financim nga institucionet vendore. Mungesa e lehtësirave fiskale dhe pagesa e taksave vendore shton barrën financiare për OSHC-të dhe ofruesit e shërbimeve për PAK.
- Fondi social mbështet zbatimin e planeve sociale, të cilat aftësinë e kufizuar e kanë trajtuar në mënyrë sipërfaqësore pa parashikime të gjithë rrjetit të shërbimeve të nevojshme për jetesën e pavarur dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës për PAK dhe familjet e tyre. Kriteret për të përfituar nga Fondi janë të paqarta. Procesi i përzgjedhjes së OSHC-ve partnere nuk është transparent, zhvillohet pa konsultimin e OSHC-ve, dhe shpesh shërbime të konsoliduara në vite falë mbështetjes nga donator, nuk përzgjidhen dhe rrezikojnë të mbyllen.
- Mospërfshirja e OSHC-ve ofruese të shërbimeve për personat PAK në proceset konsultuese, si pasojë e barrierave që ende pengojnë qasjen në informacion, komunikim dhe ambiente të aksesueshme.
- Eliminimi i pengesave/ barrierave në informacion, komunikim, transport dhe ambiente, tashmë i garantuar në kuadrin ligjor specifik për aftësinë e kufizuar, nuk gjen pasqyrim në ligje të përgjithshme si ai për informimin dhe konsultimin publik.

Rekomandime

- Problematikat me të cilat ndeshet komuniteti i PAK (15-20% të popullsisë me tendencë në rritje), të zënë vend të dukshëm në programet dhe financimet e ofruara nga organizmat shtetërorë dhe ato ndërkombëtarë, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga dokument politikë dhe ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, duke ofruar mbështetje edhe për atë pjesë të sektorit të shoqërisë civile që punon për ta çuar përpara agjendën në fushën e aftësisë së kufizuar;
- Të rishikohen planet sociale për të garantuar mbështetjen e duhur financiare për ofruesit e shërbimeve në fushën e aftësisë së kufizuar; Të rishikohen kriteret dhe të rritet transparenca sa i përket përzgjedhjes së organizatave partnere për financim nga pushteti vendor;
- Të garantohen lehtësi fiskale për OSHC-të dhe ofruesit e shërbimeve për qytetarët me aftësi të kufizuara;
- Të rishikohet ligji për informimin dhe konsultimin publik, për të theksuar eliminimin e pengesave për përfshirjen reale të personave me AK dhe OSHC-ve që përfaqësojnë e mbrojnë interesat e tyre në konsultimet publike.

*reference neni 31 i KNDPAK për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe përgjegjësitë e agjencive të ndihmës për të mbështetur zbatimin e saj

Workshop 7-Sipërmarrja sociale (SE) në zhvillimin e komuniteteve dhe ekonomisë lokale – Roli i Organizatave të Shoqërisë Civile

✓ Organizatat propozuese: Klubi i Sipërmarrësve të Rinj; Shoqata "Për Integrim Gjinnor"

Problematika

- Mungesa e skemave incentivuese që mbështesin të rinjtë dhe kategoritë vulnerabël për punësim dhe vetëpunësim.
- Skemat ekzistuese të suportit janë të vështira për t'u akeluar nga OSHC-të në nivel lokal.
- Kapacitete të ulta menaxhuese të sipërmarrjeve sociale çka ndikon në zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e tyre.
- Mungesa e platformave në vend për mbështetjen e start up-eve dhe sipërmarrjeve sociale.
- Kuadri ligjor është i paqartë, jo mundësues, madje pengon zhvillimin e sipërmarrjeve sociale.
- Kuadri fiskal ekzistues është i paqartë dhe le vend për interpretime nga ana e nëpunësve të institucioneve por edhe OSHC-ve në nivel vendor. Mungojnë incentivat fiskalë.
- SE-të në Shqipëri në përgjithësi kanë pak mundësi të përshkallëzohen dhe zgjerohen.
- SE-të kanë burime fondesh të padiversifikuara dhe varësi nga grantet.
- Mungesa e know-how për sipërmarrjet sociale.

Rekomandime

- Rishikimi i kuadrit ligjor dhe rregullator mundësues për sipërmarrjen sociale; vendosja e incentiveve fiskalë për zhvillimin e tyre.
- Hartimi i udhëzuesve të qartë në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator, për rritjen e kuptueshmërisë dhe shmangien e interpretimeve nga ana e administratës, OSHC-ve dhe sipërmarrjeve.
- Zhvillimi i programeve për rritjen e kapaciteteve të të rinjve dhe kategorive vulnerabël, për ngritjen dhe menaxhimin e startup-eve.
- Zhvillimi i platformave që ndihmojnë në ekspozimin dhe mbështetjen e startup-eve dhe krijojnë mundësi për zhvillim kapacitetesh dhe për tërheqjen e vëmendjes së investitorëve.
- Rritja e ndërgjegjësimit të aktorëve të ndryshëm në ekosistem për mekanizma alternativë financimi dhe mbështetës: ëngjëj biznesi, kapital sipërmarrës, zhvillimi i inkubatorëve dhe akseleratorëve që adresojnë sipërmarrjet sociale.
- Forcimi i njohurive për sipërmarrjen sociale, marrjen e riskut, mendësinë sipërmarrëse për të zgjidhur probleme sociale, në universitete e shkolla të mesme ku të rinjtë të edukohen hershëm me këto koncepte.

Workshop 8-Si të rrisim bashkëpunimin mes OSHC-ve dhe medias?

✓ Organizata propozuese: Dimension Human

Problematika

- Mungesë kuptimi dhe ndërgjegjësimi në sektorin e shoqërisë civile mbi misionin e medias dhe rolin e saj.
- OSHC-të nuk kanë investuar mjaftueshëm në ndërtimin e urave të bashkëpunimit me median përmes ndërgjegjësimit, informimit dhe rritjes së kapaciteteve të gazetarëve në njohjen, trajtimin dhe pasqyrimin me integritet të çështjeve që adreson sektori i OSHC-ve. Mos respektimi i parimeve të të drejtave të njeriut dhe mungesa e njohurive mbi legjislacionin përkatës në lidhje me pasqyrimin mediatik të çështjeve në fokus, shpesh ka sjellë dizinformim, e mos trajtim të rasteve në mënyrë etike.
- Mosnjohja e problemeve me të cilat vetë media ndeshet por dhe OSHC-të, ka sjellë paragjykim dhe moskuptim të ndërsjellë të punës së tyre.
- Mungesa e hapësirave në mediat publike (Radio Televizioni Publik Shqiptar) për pasqyrimin e çështjeve të adresuara nga OSHC-të. Mungon investimi në kërkimin e kësaj të drejte nga OSHC-të, kundrejt medias publike.

Rekomandime

- Programe të dedikuara për rritjen e kapaciteteve të gazetarëve (kryesisht atyre që mbulojnë çështjet sociale, dhe gazetarët e terrenit) për njohje më të thellë të legjislacionit bazë të të drejtave të njeriut dhe mbi tema/çështje sociale që janë më së shumti në fokusin e punës së OSHC-ve. Njëkohësisht, rritje e kapaciteteve të OSHC-ve për advokim mediatik dhe jo thjesht informim.
- Ngritja e mekanizmeve të bashkëpunimit me median me qëllim identifikimin e interesave të përbashkëta dhe informimin e duhur publik përtej thjesht kërkimit të një hapësire mediatike nga ana e OSHC-ve. Nxitja dhe edukimi i palëve për Media advokaci.
- Praktikat e solidaritetit dhe mbështetjes Media-OSHC duhen zhvilluar më tej, në frymë pranuese dhe bashkëpunuese e jo paragjykuese midis dy sektorëve.
- Më shumë advokim me Radio Televizionin Publik Shqiptar për zgjerimin e hapësirave të mbulimit dhe pasqyrimin mediatik të punës së OSHC-ve.

 <http://www.resourcecentre.al>